

# Akt themelimi

**Blerim Krasniqi**, i biri i Xhevat, i datëlindjes 16/05/1977 lindur në Prishtinë, Kosovë dhe banues në Tiranë, Shqipëri, i pajisur me pasaportë nr.P00825517 dhe nr. personal 1004115437

Palët janë madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, të cilët mbështetur në ligjin Nr. 9901, dt. 14.04.2008, "Për Shoqëritë Tregtare" dhe në legjislacionin shqiptar në përgjithësi, vendosën si vijon:

## **Emërtimi, Selia dhe afati i Shoqërisë**

### Neni 1

Të themelojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar për të zhvilluar veprimtari private. Shoqëria është person juridik shqiptar, veprimtaria e të cilës rregullohet nga akt themelimi, Statuti i saj dhe legjislacioni në fuqi.

### Neni 2

Shoqëria do të emërtohet "JON CONSTRUCIONS" sh.p.k

### Neni 3

Selia e shoqërisë do të jetë Lagjja nr. 4, Rruga 7 Marsi, Pall "Firma XHEMF", Kulla 3, Pranë Drejtorisë së Hekurudhës, Durrës

### Neni 4

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj me afat të pakufizuar. Ky afat mund të zgjatet ose të shkurtohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Shoqëria "JON CONSTRUCIONS" sh.p.k gëzon statusin e personit juridik shqiptar nga moment i rregjistrimit si e tillë në regjistrin e QKB-së

### Neni 5

Shoqëria "JON CONSTRUCIONS" sh.p.k do të ketë si objekt veprimtarie: **Ndërtim objekte civile dhe industriale, Punime te ndryshme ndërtimi si armim dhe disarmim armature dërrase dhe metalike, përpunime hekur ndërtimi, mirëmbajtje godinash, konsulencë në investime shitje, blerje, dhe rivleresime per pasuri të paluajtshme për vete dhe të tretë. Projektim godinash civile, industriale dhe turistike, projektim ura dhe vepra arti, projektim rruge lokale dytesore, projektim instalimesh hidrosanitare.**

### Neni 6

Selia e shoqërisë mund të tranferohet

### Neni 7

Kur shoqëria pushon veprimtarinë e saj, pasi shlyen të gjitha detyrimet që ka, pjesën e mbetur të kapitalit dhe të të ardhurave e përfitojnë ortakët e saj.

Ortakët themelues përballojnë humbjet e shoqërisë deri në kufirin e vlerës së tyre të derdhur në formimin e kapitalit themeltar. Kapitali bazë mund të rritet nga fitimi në natyrë, ose kredi në lekë ose valutë që merret në bankat e Shtetit Shqiptar.

Kapitali themeltar i Shoqërisë do të jetë ne shumen 100,000 lekë i perbere nga:

- Mjete monetare 1,000,000 lekë, që i takon ortakut themelues si më poshtë
- **Z. Blerim Krasniqi**, 1 kuotë me 100 % të kapitalit, me vlerë 1,000,000 lekë

Fitimet që do të evidentohen pas miratimit të bilancit vjetor nga Asambleja e Ortakëve pas zbritjes së taksave do të ndahen si vijon:

- Fondi rezerve
- Shpërblimi që i takon ortakëve themelues në masën 100%

### Neni 8

Shoqëri mund të hyjë në veprimtari të përbashkëta me shoqëri të tjera shqiptare ose të huaja edhe kur ato nuk kanë objekt aktiviteti atë të shoqërisë.

### Neni 9

Veprimtaria e shoqërisë mund të ushtrohet duke krijuar filiale ose përfaqësi brenda dhe jashtë vendit, konform me ligjin shqiptar ose të huaj

Të drejtat dhe detyrat e Ortakut  
Ortaku gëzon këto të drejta kryesore:

### Neni 10

- Administrimin e veprimtarisë në përputhje me kontratën dhe statutin
- Pjesmarrjen në rezultatet e çdo forme dhe sasi të veprimtarisë së shoqërisë e parashikuar në kontratën dhe statutin e saj

*Sumu*

- Paraqitjen e propozimeve dhe shqyrtimin e tyre nga Mbledhja e Asamblesë dhe organet e tjera të shoqërisë.
- Të heqë dorë nga shoqëria, heqja dorë nga shoqëria nuk e liron ortakun nga detyrimet financiare të marra më parë ndaj shoqërisë.
- Të marrë pjesë në organet e shoqërisë që janë ose mund të krijohen nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose vetë.
- Të emërojë dhe të shkarkojë përfaqësuesit e tij, punonjësit, ekspertin kontabël dhe likuidatorët.

#### Ortaku ka këto detyrime kryesore:

- Të depozitojë kuotën e tij dhe kuotën suplementare në përputhje me kontratën dhe statutin.
- Të marrë pjesë në administrimin e shoqërisë nëpërmjet organeve të krijuara nga vetë ata.
- T'i japë shoqërisë të dhënat e domosdoshme për përpunimin e çdo objekti të veçantë lidhur me veprimtarinë e saj.
- Të kryejë detyrat për realizimin e objektivave dhe të funksioneve të shoqërisë.
- Ka detyrimin nëse heqin dorë nga shoqëria t'i njoftojë vendimin e tij asamblesë 6 muaj përpara dhe duke çeduar të drejtën e zgjedhjes.
- T'i japë shoqërisë informatat e nevojshme që kanë të bëjnë me ecurinë e veprimtarisë së saj.
- Të kryejë shërbimet e nevojshme për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe realizimin e funksioneve të saj.

#### Administrimi

#### Neni 11

Organi vendimor i shoqërisë është Asambleja e Ortakëve. Sipas rëndësisë së vendimeve mbledhja e Asamblesë mund të jetë: Asambleja e zakonshme dhe Asambleja e jashtëzakonshme

Veprimtaria operative e shoqërisë drejtohet nga Administratori i saj i Përgjithshëm. Në shoqërinë "JON CONSTRUCTIONS" sh.p.k Administrator i shoqërisë do të jetë **Blerim Krasniqi**, i biri i Xhevat, i datëlindjes 16/05/1977 lindur në Prishtinë, Kosovë dhe banues në Tiranë, Shqipëri, i pajisur me pasaportë nr.P00825517 dhe nr. personal 1004115437 i cili në të njëjtën kohë ka dhe funksionin e përfaqësimit të shoqërisë me të tretët në të gjithë veprimtarinë e saj. Me miratimin e ortakëve mund të emërohen administrator dhe përfaqësues të tjerë të shoqërisë "JON CONSTRUCTIONS" sh.p.k. Administratori emërohet për një kohëzgjatje prej 5 (pesë) vjetësh financiarë me përjashtim të rasteve të dorëheqjes ose shkarkimit të parakohshëm. Administratori ka të gjitha kompetencat për të kryer të gjitha veprimet me interes të shoqërisë dhe në emër të saj nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e veprimtarisë së shoqërisë me përjashtim të atyre

*Sumari*



kompetencave që ligji nuk i njeh. Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë apo të tretëve për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit apo për faj të tij gjatë administrimit të shoqërisë.

### **Neni 12**

#### **Mbyllja e shoqërisë**

Veprimtaria e shoqërisë pushon me propozimin e bërë nga ortakët, kur gjatë dy vjetëve nuk rezulton rentabël si dhe të gjitha rastet që parashikohen në dokumentet e krijimit të shoqërisë (kontrata). Shoqëria shpërndahet në formë riorganizimi ose likuidimi.

### **Neni 13**

#### **Kur shoqëria likuqdohet:**

Asambleja e ortakëve emëron likuidatorin dhe shoqëria I jep fund veprimtarisë së saj në çastin e miratimit të këtij bilanci të likuidimit. Komisioni i Likuidimit përbëhet nga një ose tre anëtarë. Pasuritë që janë vënë në dispozicion të shoqërisë me të drejtë shfrytëzimi, shiten në varësi të shkallës së konsumit të tyre. Mjetet Financiare të fituara si rezultat i veprimtarisë së shoqërisë e të filialeve të saj dhe fondet financiare ndahen ndërmjet ortakëve

në përpjestim me kuotat e vëna, pasi janë bërë pagesat për kreditorët.

### **Neni 14**

Kur pushon veprimtaria e një filiali, për efekte të riorganizimit të tij, afatet e pushimit caktohen nga Asambleja e Ortakëve. Likuidimi i filialeve bëhet njëjloj si për shoqërinë. Mjetet financiare të fituara si rezultat i veprimtarisë së filialit të likuiduar dhe fondet e tij financiare vihen në dispozicion të shoqërisë pasi të jenë bërë pagesat likuidatorëve. Dispozita të hollësishme mbi organizimin e kësaj shoqërie përcaktohen në statutin e saj.

Durrës më 20/11/2023

**Ortakët i vetëm i shoqërisë**

**Blerim Krasniqi**

**BLERIM KRASNIQI**

*Blerim Krasniqi*